



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr 356/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbartimore të kreditorit E... SH.P.K me seli në Prishtinë, të cilin e përfaqëson Jeton Idrizi avokat nga Prishtina, kundër debitorit Telekom i Kosovës, Sh. A me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr 941/2020 të datës 23.10.2020 të Përmbartuesit Privat Emine Sherifi - Lubeniqi, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 30.08.2022, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit Telekom i Kosovës, Sh. A me seli në Prishtinë, i paraqitur kundër urdhrit përmbartimor P.nr 941/2020 të datës 23.10.2020 të Përmbartuesit Privat Emine Sherifi - Lubeniqi.
- II. MBETET në fuqi Urdhri P.nr 941/2020 i datës 23.10.2020 i lejuar nga Përmbartuesi Privat Emine Sherifi - Lubeniqi në Prishtinë.
- III. DETYROHET debitori që në emër të shpenzimeve për përpilimin e përgjigjes në prapësim të i'a paguaj kreditorit shumën prej 104.00 € (njëqind e katër euro) në afat prej 7 (shtatë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat Emine Sherifi - Lubeniqi, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit EGS SH.P.K me seli në Prishtinë, ka caktuar urdhrin P.nr 941/2020 me datën 23.10.2020, duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm - Faturës nr. 20 SHV01-001-36 të datës 27.02.2020, Faturës nr. 20 SHV01-001-37 të datës 27.02.2020, Faturës nr. 20 SHV01-001-38 dhe Faturës nr. 20 SHV01-001-39 të datës 27.02.2020, me të cilin e ka urdhëruar debitorin Telekom i Kosovës, Sh. A, me seli në Prishtinë që në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturave të lartcekura, të paguaj shumën prej 3.380.00 € (tre mijë e treqind e tetëdhjetë euro) me kamatë

ligjore prej 8 % duke filluar nga data e arritjes së faturave për pagesë deri në pagesën përfundimtare, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore dhe ato të përmbaruesit privat me ndalim të mjeteve dhe regjistrimin, sekuestrimin, vlerësimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor ka deklaruar se e kundërshton propozimin për përmbarim duke theksuar se urdhri si i tillë nuk mund të ekzekutohet dhe nuk është i përmbarueshëm ngase dokumentet e bashkëngjitura në propozimin për përmbarim, nuk e kanë cilësinë e dokumentit të besueshëm dhe se kërkesa e kreditorit nuk është e bazuar dhe është në kundërshtim me dispozitat e LPP-së, duke shtuar se faturat kontestuese në rastin konkret nuk i janë bashkëngjitur propozimit në origjinal. I ka propozuar gjykatës që të pranohet si i bazuar prapësimi i debitorit dhe të abrogohet urdhri përmbarimor si dhe të obligohet kreditori i përmbarimit që ti bartë shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Kreditori përmes të autorizuarit të tij, në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ndër të tjera ka deklaruar se nuk qëndrojnë pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim dhe se të njëjtat janë të pabazuara, duke shtuar se faturat në bazë të së cilave është ushtruar propozimi për përmbarim kanë cilësinë e dokumentit të besueshëm, të njëjtat janë dorëzuar në origjinal dhe në 3 kopje, duke i propozuar Gjykatës që të refuzoj prapësimin e debitorit në tërësi. Shpenzimet e procedurës përmbarimore, për përpilimin e përgjigjes në prapësim i ka kërkuar në shumën e përcaktuar prej 104 € (njëqind e katër euro).

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim si dhe përgjigjes në prapësim të kreditorit, gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar, nga fakti se debitori nuk ka ofruar asnjë provë me shkrim konform nenit 69 paragrafi 4 të Ligjit NR. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (tutje LPP).

Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat në bazë të së cilave është lejuar urdhri për përmbarim, i plotësojnë kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmbarshëm të gjitha elementet e kërkuara dhe janë të përshtatshme për përmbarim, bazuar në dispozitat e nenit 29 par.3 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*. Me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata konstaton se në këtë çështje përmbarimore urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm – përkatësisht Faturën nr. 20 SHV01-001-36 të datës 27.02.2020; Faturën nr. 20 SHV01-001-37 të datës 27.02.2020; Faturën nr. 20 SHV01-001-38 dhe Faturën nr. 20 SHV01-001-39 të datës 27.02.2020 dhe gjeti se të njëjtat përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, ngase në këto fatura janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara mallrat të cilat kanë qenë objekt i kësaj marrëveshje afariste, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP, për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që të njëjtat janë dorëzuar në origjinal, janë të nënshkruara nga debitori, mbajnë vulën e pranimit të debitorit, nuk janë kontestuar nga debitori dhe kërkesat nga këto fatura janë bërë të arritshme me datën 16.03.2020.

Në rastin konkret rezulton se Fatura nr. 20 SHV01-001-36 në vlerë prej 999.00 € (nëntëqind e nëntëdhjete e nëntë euro); Fatura nr. 20 SHV01-001-37 në vlerë prej 950.00 € (nëntëqind e pesëdhjetë euro); Fatura nr. 20 SHV01-001-38, në vlerë prej 999.00 € (nëntëqind e nëntëdhjete e nëntë euro) dhe Fatura nr. 20 SHV01-001-39, në vlerë prej 432.00 € (katër qind e tridhjetë e dy euro) janë lëshuar me datën 27.02.2020 nga ana e kreditorit, ndërsa janë pranuar në

mënyrë të rregullt nga debitori me datën 02.03.2020 dhe për të cilat afati i fundit për pagesë ka qenë data 15.03.2020.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata lidhur me këtë çështje përmbare, vlerëson se urdhri për përmbare i lejuar mbi bazën e dokumentit të besueshëm nuk është në kundërshtim me dispozitën e Nenit 29 të LPP-së, pasi që nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbaremit e të cilat janë të parashikuara në nenin 71 të LPP-së.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës përmbare, gjykata ka vendosur në kuptim të dispozitave të nenit 463 dhe 453 par.2 të LPK-së, lidhur me nenin 17 dhe 13 par.4 të LPP-së, duke ia njohur shpenzimet e të autorizuarit të kreditorit në shumën prej 104.00 € (njëqind e katër euro) për përpilimin e përgjigjes në prapësim.

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke u bazuar në nenin 5.par.5 dhe 73 të LPP-së dhe nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale.

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr 356/22, datë 30.08.2022.

Gjyqtari

Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi

palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve,

nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale, në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.